

VENDIM
Nr. 541, datë 7.8.2012

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË BASHKIA KUKËS,
TË PRONËS NR. 437, ME EMËRTIM “QENDRA E MOBILIZIMIT”, ME VENDNDODHJE NË
KUKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të bashkia Kukës, të pronës nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, me vendndodhje në Kukës, sipas formularit tip të inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për çerdhe dhe kopsht, për plotësimin e nevojave të komunitetit të bashkisë Kukës.

2. Prona nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, Kukës, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Bashkisë Kukës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, në Kukës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, kryetari i bashkisë Kukës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha